



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SHKENCËS



Luxembourg Development  
Cooperation Agency

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT  
KSV/801 20 2484

Pranuar më: 17.09 2020		
Printime:		
Njësia Jedinica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-610-	44878	

Për realizimin e mbështetjes për shkollën e mesme profesionale  
"Adem Gllavica", zyrat dhe institucionet e arsimit në Komunën e  
Lipjanit

Në kuadër të Projektit KSV/801 – ESJET PRO "Mbështetja e  
Bashkimit Evropian për Rikualifikimet Profesionale dhe Profesionet  
në AAP"

Ndërmjet

Komunës së Lipjanit – Republika e Kosovës  
(tani e tutje i referohemi si "Komuna")

Dhe

Lux-Development S.A në emër të Projektit KSV/801  
"Mbështetja e Bashkimit Evropian për Rikualifikimet Profesionale dhe Profesionet në  
AAP", të financuar nga Bashkimi Evropian  
(tani e tutje i referohemi si "ESJET PRO")

Shtator 2020



## 1. Konteksti

DUKE E PASUR PARASYSH se Arsimi dhe Aftësimi Profesional (AAP) pritet të luajë një rol kyç në zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës, nxitjen e rritjes ekonomike dhe kohezion;

DUKE E PASUR PARASYSH një sistem efektiv i AAP-së duhet ta zhvillojë një fuqi punëtore të "gatshme për punë" për t'i plotësuar nevojat e bizneseve dhe për të promovuar të nxënit gjatë tërë jetës në hap me ndryshimet në tregun global;

DUKE E PASUR PARASYSH se Republika e Kosovës përballet me sfidën e hendekut në rritje ndërmjet njohurive dhe shkathtësive që zhvillohen gjatë arsimimit dhe cilësisë që kërkohet nga punëdhënësit, si dhe për vetë-punësim;

DUKE E PASUR PARASYSH se bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë e Arsimit dhe Shkencës, Agjencisë së Luksemburgut për Zhvillim të Bashkëpunimit dhe të përfituesve është rregulluar përmes një marrëveshje bilaterale në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut të nënshkruar me 23 prill, 2013;

DUKE E PASUR PARASYSH se LuxDev, Agjencia e Luksemburgut për Zhvillim të Bashkëpunimit, është caktuar nga Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë për zbatimin e Projektit KSV/801 "Mbështetja e Bashkimit Evropian për Rikualifikimet Profesionale dhe Profesionet në AAP";

DUKE E PASUR PARASYSH se MASH është caktuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të qenë homolog i Projektit ESVET PRO në zbatimin e projektit KSV/801 "Mbështetja e Bashkimit Evropian për Rikualifikimet Profesionale dhe Profesionet në AAP";

DUKE E PASUR PARASYSH se MASH-i e ka përkrahur mbështetjen e LuxDev për Shkollën e Mesme Teknike "Adem Gllavica" në Lipjan, në kuadër të Projektit KSV/801 "Mbështetja e Bashkimit Evropian për Rikualifikimet Profesionale dhe Profesionet në AAP";

DUKE E PASUR PARASYSH se Memorandumi aktual i Mirëkuptimit (MM) do të jetë pjesë e kornizës normative të partneritetit të ardhshëm ndërmjet shkollave të AAP-së dhe organizatave dhe kompanive të sektorit privat, bashkërisht me kontratën ad hoc për shërbime ndërmjet LuxDev dhe partnerëve të përzgjedhur;

PRANDAJ, Komuna dhe LuxDev kanë rënë dakord si më poshtë:



## 2. Fushëveprimi i partneritetit

Projekti ESVET PRO në kuadër të marrëveshjes, do të ofrojë mbështetje për institucionet e AAP-së në nivel vendi dhe në nivel komunal, veçanërisht në zhvillimin e kurrikulave (duke përfshirë Standardet e Profesionit - SP), materiale mësimore (MM), zhvillim të kapaciteteve të stafit drejtues dhe mësimdhënësve, pajisje, udhëzues dhe doracakë, reformën e kornizës ligjore, në strukturën qeverisëse të AAP-së, sistemet e informimit dhe mjetet dhe infrastrukturën digjitale, në ofrimin e këshillimit në karrierë dhe në shërbimet tjera të orientuara në arsim dhe punësim, në asistencë teknike dhe shumë masa tjera që kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësinë në sistemin e AAP-së në Kosovë.

Në nivel të shkollave të AAP-së, në kuadër të intervenimeve më të rëndësishme të planifikuara, njëra nga këto intervenime është objekt kryesor i interesit për Komunën e Lipjanit dhe ka të bëjë me përzgjedhjen e shkollave të AAP-së të cilat përfaqësojnë një prioritet për zhvillimin e sektorit në Kosovë, të cilat do të marrin mbështetje në aspektin e kurrikulave, materialeve mësimore, zhvillimin e kapaciteteve dhe do të përfitojnë nga përvoja e fituar gjatë intervenimit të mëhershëm të udhëhequr nga ekipi LuxDev në Kosovë (d.m.th. nga Projekti KSV/020 dhe Projekti KSV/015).

Projekti ESVET PRO e ka realizuar një proces të hollësishëm të hulumtimit për t'i përzgjedhur shkollat përfituese të AAP-së në Kosovë dhe do t'i shqyrtojë mundësitë e dakordimit me MASH dhe me komunalat përkatëse lidhur me mënyrën e formalizimit dhe zbatimit të mbështetjes.

Projekti, pas konsultimeve me MASH dhe Komunën e Lipjanit, e ka identifikuar Shkollën profesionale "Adem Gllavica" si përfituesin më adekuat, për tu avancuar, me mbështetjen e plotë të Projektit ESVET PRO, dhe ndonjë partneri ose sponsori tjetër që do të identifikohet nga Projekti.

Palët i ndajnë përgjegjësitë për të siguruar zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve përcjellëse.

## 3. Përshkrimi i përgjithshëm i mbështetjes, aktiviteteve dhe rezultatet

Fushëveprimi i Projektit është që të përfitohet nga përvoja e pararendësit të Projektit aktual, Projekti KSV/015 dhe Projekti KSV/020, dhe të zbatohet një koncept i ri i shkollës së AAP-së duke i aplikuar elementet më të rëndësishme të sistemit dual të arsimit profesional të vendeve me të zhvilluara (d.m.th. Zvicrës, Austrisë apo Gjermanisë), dhe duke ia përshtatur realitetit socio-ekonomik të Kosovës. Shkollat tjera profesionale që mbështeten nga Projekti do të kërkojnë partneritete të qëndrueshme me organizatat, kompanitë dhe punëdhënësit privat në përgjithësi, për ta rritur cilësinë e mësimdhënies, kërkesën dhe nivelin e qëndrueshmërisë financiare të këtyre shkollave.

### 3.1 Zhvillimi i SP-ve, kurrikulave, materialeve mësimore

Duke u bazuar në qasjen e kërkesës së tregut të punës, Projekti do ta mbështes rishikimin, përditësimin dhe identifikimin e profileve dhe kualifikimeve specifike që do të zhvillohen në Shkollë Profesionale. Në bashkëpunim me partnerët e përzgjedhur të jashtëm dhe ofruesit e shërbimeve, kualifikimet do të zhvillohen duke u bazuar në standarde të reja të profesionit të cilat do ta reflektojnë nevojën reale të tregut vendor dhe ndërkombëtar të punës. Kurrikulat do të zhvillohen për të krijuar një balancë optimale ndërmjet mësimin teorik dhe atij praktik që do t'iu mundësojë nxënësve të kyçen më lehtë në tregun e punës menjëherë pas diplomimit, si dhe me mundësi të zhvillimit të disa programeve të orientuara në vazhdimin e shkollimit të lartë.

Materialet mësimore do të zhvillohen dhe do të jenë të qasshme për nxënësit me një kosto sa më të favorshme që është e mundur, duke synuar qëndrueshmërinë financiare të shkollës.

Kurdo që është e mundur, cilësia e arsimit duhet të jetë në përputhje me standardet evropiane ose ndërkombëtare.

### 3.2 Pajisjet dhe inventari

Projekti do të ndajë vetëm disa fonde të kufizuara për inventarë dhe pajisje teknike, përderisa do të mbështesë shkollën në hulumtimin dhe gjeljen e burimeve tjera për blerje të pajisjeve për realizimin e mësimin teorik dhe aftësimin praktik për nxënësit e profileve dhe kualifikimeve të përzgjedhura që do të mbështeten me standarde të reja të profesionit, dhe me kurrikula dhe materiale mësimore. Komuna do të zotohet që do të alokojë disa fonde në kufi të kapacitetit të saj për të kontribuar në këtë komponentë.

Punët dhe blerjet do të realizohen nën mbikëqyrjen e Projektit dhe nga furnitorët dhe ofruesit e shërbimeve të përzgjedhur në përputhje me rregullat e prokurimit të Projektit të LuxDev.

### 3.3 Zhvillimi i kapaciteteve dhe menaxhimi i qëndrueshëm



Në këtë rrugëtim të zhvillimit dhe zbatimit të qasjes së sistemit dual të mësimi që i përshtatet kontekstit socio-ekonomik të Kosovës, dhe në përputhje me udhëzuesin për Modelin e Biznesit të hartuar nga MASH me përkrahjen e Projektit KSV/015 dhe KSV/020, Projekti ESJET PRO do ta mbështesë zhvillimin e kapaciteteve të brendshme të Shkollës Profesionale, në nivel të stafit drejtues dhe në nivel të mësimdhënësve.

Mësimdhënësit do të duhet të aftësohen për t'i realizuar rezultatet mësimore, dhe nëse kërkohet rekrutim shtesë, përzgjedhja duhet të bëhet në bazë të meritave dhe kompetencave të tyre.

Për të mundësuar një menaxhim më cilësor dhe më të qëndrueshëm financiar, Projekti mund t'i përzgjedhë një ose më shumë partnerë të cilëve do t'ua delegojë pjesërisht ose në tërësi disa aspekte të menaxhimit të shkollës. Përzgjedhja e këtyre partnerëve do të bëhet në përputhje me procedurat e prokurimit të LuxDev, me qëllim të përzgjedhjes së partnerëve ekonomikisht më të përshtatshëm.

Shkolla Profesionale, në partneritet me akterët privatë, nuk do të ofrojë vetëm arsim formal, por do të ofrojë edhe kurse të shkurtra, arsim për të rritur, aftësim në vend të punës ose mundësi punësimi për nxënësit ose për komunitetin, shërbime tjera të orientuara në përfitim të përbashkët shoqëror, zhvillim të start-up bizneseve, të ngritë zhvillimin e sektorëve të profileve përkatëse në Kosovë dhe mundësi për hulumtime, e në veçanti të ngritë qëndrueshmërinë financiare të vetë shkollës (d.m.th., aktivitete për gjenerimin e të hyrave, nëse është e aplikueshme).

### 3.4 Asistenca teknike dhe bashkërendimi me reformat në nivel vendi

Projekti do të ofrojë asistencë teknike të vazhdueshme për Shkollën Profesionale, dhe kur është e mundur edhe për komunën, për të siguruar një bashkërendim të vazhdueshëm me reformat dhe aktivitetet që promovohen në nivel vendi. Për shembull, në zbatimin e udhëzuesit për Zyrën e Modelit të Biznesit, shërbimet për këshillim në karrierë, sistemet e informimit dhe mjetet digjitale, si dhe aktivitetet tjera përcjellëse në të mirë të zhvillimit socio-ekonomik.

## 4. Rolet dhe obligimet e palëve

### 4.1 Komuna e Lipjanit

- 4.1.1 Komuna e kupton se si rezultat i mbështetjes që do të pranojë, shkolla e përzgjedhur e AAP-së do të ketë nevoja dhe kërkesa më të mëdha. Për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave, me mbështetje të Projektit ESJET PRO, do të zhvillohet një model i ri i qeverisjes së shkollës, i cili do të përfshijë një marrëveshje me partnerët e përzgjedhur, siç është cekur në Nenin 3.3 të këtij memorandumit të mirëkuptimit. Komuna do të zotohet ta zbatojë këtë model të ri të qeverisjes së shkollës, dhe t'i formalizojë dhe respektojë marrëveshjet e partneritetit të krijuara në kuadër të mbështetjes që rrjedhë nga ky Memorandum i mirëkuptimit me Projektin ESJET PRO.
- 4.1.2 Komuna do t'i ofrojë mbështetje të plotë Projektit dhe partnerëve të ardhshëm (siç përcaktohet nëpërmjet partneriteve të modelit të ri të qeverisjes së shkollës, në përputhje me nenin 3.3 dhe në pikën 4.1.1 të këtij Memorandumit të Mirëkuptimit) me qëllim që ta lehtësojë realizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara dhe arritjen e objektivave të përcaktuara.
- 4.1.3 Komuna do të zotohet që t'i planifikojë dhe buxhetojë me kohë financimin e të gjitha shpenzimeve të shkollës (personeli, shërbimet komunale, mirëmbajtja, etj.) siç parashihet me ligjet e Kosovës.
- 4.1.4 Komuna do të zotohet ta njohë rolin e Projektit ESJET PRO LuxDev dhe/ose partnerëve të ardhshëm që identifikohen nga Projekti për sa i përket vlerësimi të performancës së mësimdhënësve dhe të stafit drejtues të Shkollës Teknike, dhe të veprojë sipas rekomandimeve të Projektit ESJET PRO dhe partnerëve tjerë që themelohen përmes këtij bashkëpunimi, konform ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës që rregullojnë këto çështje (p.sh. shmangien nga angazhimet e panevojshme, të paqëndrueshme ose të papërshtatshme, kontratat dhe shpenzimet, punësimi i stafit, ripërtëritja dhe ndërprerja e kontratave të punës, etj.).
- 4.1.5 Komuna do të zotohet të lejojë dhe të garantojë prerogativat e partnerëve të LuxDev dhe të Projektit në rolin e tyre në kuadër të koordinimit dhe menaxhimit të shkollës sipas modelit të qeverisjes së lartë-cekur që pritet të zhvillohet.

Prof. Dr. Ismet Krasniqi

- 4.1.6 Komuna zoton shumën prej 5000 EUR për vitin akademik 2020-2021 ku shuma e alokuar do t'i përshtatet nevojave të shkollës në përputhje me prioritetet specifike të identifikuar nga LuxDev përmes Projektit. Komuna zotohet që të mbështes financiarisht shkollën për vitin akademik 2021-2020 dhe poashtu zotohet të rrisë shumën e alokuar sipas nevojave të shkollës. Procedura e prokurimit do të kryhet nga Projekti ESVET PRO ndërsa angazhimi kontraktual nga ana e Komunës së Lipjanit.
- 4.1.7 Komuna angazhohet të kërkojë fonde shtesë nga burimet publike dhe private për të lehtësuar zhvillimin e mëtejshëm të shkollës dhe zbatimin e aktiviteteve të Projektit, veçanërisht në drejtim të qëndrueshmërisë financiare dhe përmirësimit të ofertës së AAP të institucionit të mbështetur.
- 4.1.8 Komuna zotohet të inkurajojë palët (zyrtarët e Komunës dhe/apo shkollës) që në mënyrë aktive të marrin pjesë në identifikimin e profileve të cilat duhet të zhvillohen Standardet e Profesionit – SP), materiale mësimore (MM), etj.
- 4.1.9 Komuna zotohet të sigurojë një bashkëpunim të ngushtë dhe të pa penguar ndërmjet Projektit dhe shkollës që mbështetet nga Projekti.
- 4.1.10 Komuna zotohet të asistojë shkollën në arritjen e marrëveshjeve të parteritetit me kompanitë e sektorit privat me qëllim të themelimit të parteriteteve ku studentët mund të përfundojnë punën praktike.
- 4.1.11 Komuna zotohet t'i inkurajojë mësimdhënësit dhe stafin drejtues të shkollës që të marrin pjesë në trajnimet që organizohen lidhur me komponentin e zhvillimit të kapaciteteve në kuadër të Projektit.
- 4.1.12 Obligimet e lartë-cekura aplikohen për të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me mbështetjen e Projektit ESVET PRO dhe aktivitetet që rrjedhin nga kjo mbështetje.


#### 4.2 Projekti KSV/801

Projekti do të jetë përgjegjës për të ofruar mbështetje, në kuadër të mandatit të vetë dhe duke u bazuar në Dokumentin Teknik dhe Financiar të Projektit, për zbatimin e aktiviteteve të cilat në mënyrë specifike i atribuohen atij sipas Kapitullit 3 të këtij Memorandumi, përveç mbikëqyrjes dhe detyrave tjera të përcaktuara në kontratat e ardhshme për shërbime dhe marrëveshjet e partneritetit.

Përveç kësaj, Projekti do t'i mbulojë shpenzimet që kanë të bëjnë me aktivitetet dhe mbështetjen e lartë-cekur, duke e përfillur në mënyrë ekskluzive buxhetin, rregullat dhe prioritetet strategjike të përcaktuara nga strukturat qeverisëse dhe në Dokumentin Teknik dhe Financiar të Projektit.

Aktivitetet që do të mbështeten nga Projekti ESVET PRO janë si më poshtë:

- 4.2.1 Ofrimi i pajisjeve teknike për menaxhimin e shkollës dhe realizimin e aftësimit praktik dhe aktiviteteve që ndërlidhen me profilet e mbështetura që zhvillohen në shkollën profesionale;
- 4.2.2 Asistencë në planin zhvillimor të shkollës, duke përfshirë të gjitha aspektet relevante për ta realizuar inaugurimin efektiv dhe zbatimin e qëndrueshëm të programeve të AAP-së dhe të menaxhimit efikas të shkollës (p.sh. organogrami, strategjia dhe plani zhvillimor, proceset e biznesit, sistemi i sigurimit të cilësisë, proceset e menaxhimit, kodi i sjelljes, etj.);
- 4.2.3 Zhvillimi i kualifikimeve të reja në teknike, duke përfshirë Standardet e profesionit, kurrikulat e bazuara në kompetenca dhe materialet mësimore;
- 4.2.4 Mbështetje në përzgjedhjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit të mësimdhënësve dhe atij administrativ dhe themelimi i një ekipi drejtues kompetent, etj.;
- 4.2.5 Mbledhja e informatave mbi tregun e punës dhe zhvillimi i anketave të ndryshme;
- 4.2.6 Mbështetja dhe lehtësimi i të gjitha proceseve që kanë të bëjnë me zhvillimin, validimin dhe akreditimin e standardeve të profesionit dhe kualifikimeve;
- 4.2.7 Identifikimi dhe zhvillimi i stimujve, strategjive të marketingut dhe zbatimi i çfarëdo aktiviteti që synon rritjen e efikasitetit, efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së Shkollës Profesionale dhe ofertës së AAP-së;
- 4.2.8 Zhvillimi i politikave të regjistrimit të nxënësve dhe përcaktimi i procesit dhe mjeteve të përzgjedhjes së nxënësve;



- 4.2.9 Zhvillimi dhe zbatimi i një modeli më efikas të menaxhimit (d.m.th., Modeli i Biznesit<sup>1</sup>);
- 4.2.10 Si pjesë e mbështetjes nga Projekti ESVET PRO, zhvillimi i Modelit të Biznesit përfshinë edhe zhvillimin e komponentëve të tij, siç janë: zhvillimi i bashkëpunimit me industrinë, shërbimeve për këshillim në karrierë, aktivitetet e bashkë-krijimit dhe të kapaciteteve dhe kompetencave të njesisë për ofrimin e shërbimeve;
- 4.2.11 Zhvillimi i një sistemi të ri për menaxhimin financiar dhe i një strategjie dhe plani të qëndrueshëm financiar.

## 5 Buxheti

Alokimi i burimeve financiare dhe atyre njerëzore nga Projekti për aktivitetet që ndërlidhen me këtë Memorandum do të jenë në përgjegjësi ekskluzive të strukturave drejtuese të Projektit ESVET PRO dhe në përputhje me Dokumentin Teknik dhe Financiar të Projektit.

Palët mund të përfshijnë anekse të ardhshme lidhur me alokimin e buxhetit që do të bëhen pjesë përbërëse e këtij Memorandumi.

## 6 Kohëzgjatja e Memorandumit të Mirëkuptimit

Ky Memorandum i Mirëkuptimit do të hyjë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga të gjitha palët e përfshira dhe do të zgjatë deri në mbylljen e Projektit ESVET PRO, i paraparë për dhjetor 2022.

## 7 NDRYSHIMET DHE NDËRPRERJA E MARRËVESHJES

Një kërkesë eventuale për ndërprerjen e parakohshme të kësaj marrëveshjeje do të justifikohet dhe do të dorëzohet vetëm në rastet e një force madhore apo në rastet kur ekziston një interes i dukshëm dhe i dëshmuar për zhvillimin më të mirë të sektorit të AAP-së në Kosovë, për përfituesit e projektit ESVET PRO, mirëqenies së popullatës së Kosovës, respektimit të ligjit, respektimit të kodit të sjelljes së LuxDev, ose në rast se kërkohet një gjë e tillë nga strukturat drejtuese të Projektit ESVET PRO. Në rastet e këtyra, ndërprerja e marrëveshjes duhet t'i komunikohet me shkrim palës tjetër me një njoftim paraprak me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditësh.

## 8 DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Në rast të vështirësive në zbatimin e kushteve të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, palët do të konsultohen me njëra-tjetrën menjëherë.

Amendamentet, shtojcat dhe ndryshimet në këtë Memorandum mund të bëhen vetëm në bazë të pëlqimit me shkrim të palëve të përfshira në çfarëdo kohe.

Ky Memorandum i Mirëkuptimit është përpiluar në dy (2) kopje origjinale dhe identike në gjuhën angleze.

Secila palë nënshkruese do ta mbajë nga një kopje origjinale, të nënshkruar dhe të vulosur nga përfaqësuesit e palëve nënshkruese.

Ky Memorandum i Mirëkuptimit është përpiluar në gjuhën angleze dhe është përkthyer në gjuhën shqipe. Në rast të mospërputhjeve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze.



Prof. Idriz Fazli

<sup>1</sup> Zyra e Modelit të Biznesit (ZMB) është një instrument që është zhvilluar për t'i ndihmuar institucionet e AAP-së në bashkërendimin e programeve të tyre me nevojat e tregut të punës, si dhe të bëhet urë-lidhëse në mes të industrisë dhe nxënësve të diplomuar të shkollave të AAP-së. Misioni kryesor i Zyrës së Modelit të Biznesit është që ta rrisë relevancën e tregut dhe mënyrën e veprimit të shkollave të AAP-së dhe Qendrave të Kompetencës nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të Standardeve të Profesionit, kurrikulave dhe materialeve mësimore (MM). Përveç kësaj, kjo zyre është edhe një mekanizëm nëpërmjet të cilit shkollat mund të zhvillojnë partnerite me kompanitë private me qëllim të ofrimit të mundësive për zhvillim profesional të nxënësve nëpërmjet praktikës profesionale. Kjo zyre është shpallur fillimisht në kuadër të Projektit KSV/015 si një ndër shtyllat kryesore për zhvillimin e qeverisjes së shkollave të AAP-së dhe përbëhet nga katër komponentë kryesore të ndara në tri njësi strukturore: I) Ndërlidhja me Industrinë dhe Këshillimi në Karrierë, II) Sistemet e Informimit dhe Menaxhimi i të Dhënave, si dhe III) Njësia për Ofrimin e Shërbimeve. Nëpërmjet Projektit KSV/020, ky Model i Biznesit është themeluar në 11 institucione (shkolla dhe Qendra të Kompetencës).

Në emër të Komunitetit



Emri: Imri Ahmeti  
Pozita: Kryetar i Komunitetit  
Së Lipjanit

Data:

Në emër të LuxDev

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Daniele Cristian Passalacqua".

Emri: Daniele Cristian Passalacqua  
Pozita: Këshilltar Kryesor Teknik  
Projekti KSV/801 LuxDev

Data:

